

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të  
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Kontabiliteti Menaxherial  
(zgjidhjet)

**P2**

Nr.

FLETË PROVIMI  
Exam Paper

**Udhëzime/Instructions:**

1. MOS E HAPNI DERISA T'JU LEJOHET PREJ  
MBIKËQYRËSIT  
Do Not Open Until Your Invigilator Allows You to Do So.

2. ËSHTË E DETYRUESHME PËRGJIGJA E GJITHA  
PYETJEVE  
All Questions Are Mandatory

3. KOHA E LEJUAR ËSHTË 3 ORË  
Time Allowed is 3 Hours

4. EMRI JUAJ NUK DUHET TË PARAQITET NË ASNJË  
FLETË TË KËTIJ PROVIMI.  
Your name should appear nowhere in this test.

Data 31.01.2026

CONTENT / PËRMBAJTJA

<b>SESSION</b>	<b>MAXIMUM ASSIGNED</b>	<u>-ATTENTION! THIS PART IS FOR SCAAK USE ONLY- MARKS AWARDED</u>
1. Problem 1	20	
2. Problem 2	20	
3. Problem 3	20	
4. Problem 4	20	
5. Problem 5	20	
<b>Total</b>	100	

## Problemi 1

Muvumba Ltd është një kompani që prodhon një produkt, "the splash". Në fillim të periudhës 1, nuk kishte gjendje fillestare të inventarit. Informacioni i mëposhtëm lidhet me koston variabël për njësi dhe koston fikse për periudhë.

<b>Kostoja variabël për njësi</b>	<b>€</b>
Materiale direkte	1,200
Punë direkte	2,400
Shpenzime të përgjithshme variabël prodhimi	800
Shpenzime të përgjithshme fikse prodhimi	1,600
Shpenzime të përgjithshme variabël shitjeje	600
<b>Gjithsej</b>	<b>6,600</b>

  

<b>Kostoja fikse për periudhë</b>	<b>€</b>
Shpenzime të përgjithshme fikse prodhimi	40,000,000
Shpenzime të përgjithshme fikse shitjeje	36,000,000
<b>Gjithsej</b>	<b>76,000,000</b>

### **Informacione shtesë:**

1. Çmimi i shitjes për njësi ishte € 8,000.
2. Kompania planifikoi të prodhonte dhe të shiste 25,000 njësi për periudhë.
3. Prodhimi dhe shitjet aktuale për periudhën 1 dhe 2 janë siç paraqiten në tabelën e mëposhtme:

	<b>Njësitë e prodhuara</b>	<b>Njësitë e shitura</b>
Periudha 1	25,000	20,000
Periudha 2	25,000	27,500

4. Nuk ka stok fillestar ose punë në proces në periudhën 1.

### **Kërkohet:**

a) Përgatitni pasqyrën e fitimit sipas Kostos Marginale për periudhën 1 dhe 2 (10 Pikë)

b) Përgatitni pasqyrën e fitimit sipas Kostos së Përthithjes/Absorbimit për periudhën 1 dhe 2 (10 Pikë)

(Gjithsej: 20 Pikë)

## Problemi 1 - Zgjidhjet

### *a) Pasqyra e Fitimit sipas Kostos Marginale*

Në këtë metodë, vetëm kostot variabël të prodhimit përfshihen në koston e produktit. Kostot fikse trajtohen si kosto të periudhës.

<b>Përshkrimi</b>	<b>Periudha 1 (€)</b>	<b>Periudha 2 (€)</b>
<b>Shitjet</b>	<b>160,000,000</b>	<b>220,000,000</b>
	*P1: 20,000 x 8,000	P2: 27,500 x 8,000*
<b>Minus: Kostoja Variabël e Shitjeve</b>		
Inventari fillestar (0*4000) (5,000*4,000)	0	22,000,000
Shto prodhimin (25,000 x 4,400*)	110,000,000	110,000,000
Minus inventarin fund (5,000*4,400) (2,500*4,400)	(22,000,000)	(11,000,000)
<b>Kostoja Variabël e Prodhimit</b>	<b>(88,000,000)</b>	<b>(121,000,000)</b>
Minus shpenzimet variabël të shitjes (20,000*600) (27,500*600)	(12,000,000)	(16,500,000)
<b>Kontributi</b>	<b>60,000,000</b>	<b>82,500,000</b>
<b>Minus Kostot Fikse</b>		
Prodhimi	(40,000,000)	(40,000,000)
Jo-prodhimi (Shitja)	(36,000,000)	(36,000,000)
<b>Fitimi / (Humbja) Marginale</b>	<b>(16,000,000)</b>	<b>6,500,000</b>

\*Llogaritja e Kostos Variabël për Njësi:  $1,200 + 2,400 + 800 = 4,400$  €.

### *b) Pasqyra e Fitimit sipas Kostos së Përthithjes*

Në këtë metodë, të gjitha kostot e prodhimit (variabël dhe fikse) përfshihen në koston e produktit.

<b>Përshkrimi</b>	<b>Periudha 1 (€)</b>	<b>Periudha 2 (€)</b>
<b>Shitjet</b>	<b>160,000,000</b>	<b>220,000,000</b>
<b>Minus: Kostoja e Shitjeve</b>	P1 (20,000*8,000)	P2 (27,500*8,000)
Inventari fillestar (0*6,000) (5,000*6,000)	0	30,000,000
Shto prodhimin (25,000 x 6,000**)	150,000,000	150,000,000
Minus inventarin fund (5,000*6,000)(2,500*6,000)	(30,000,000)	(15,000,000)
<b>Kostoja e Shitjeve (Totale)</b>	<b>(120,000,000)</b>	<b>(165,000,000)</b>
<b>Fitimi Bruto</b>	<b>40,000,000</b>	<b>55,000,000</b>
<b>Minus Shpenzimet e Periudhës</b>		

<b>Përshkrimi</b>	<b>Periudha 1 (€)</b>	<b>Periudha 2 (€)</b>
Shpenzime fikse shitjeje	(36,000,000)	(36,000,000)
Shpenzime variabël shitjeje (20,000*600) (27,500*600)	(12,000,000)	(16,500,000)
<b>Fitimi / (Humbja) Neto</b>	<b>(8,000,000)</b>	<b>2,500,000</b>

*\*\*Llogaritja e Kosos Totale të Prodhimit për Njësi: 4,400 (Variabël) + 1,600 (Fikse) = 6,000 €.*

**Shënim:** Diferenca në fitim midis dy metodave vjen nga vlera e inventarit. Në Periudhën 1, fitimi sipas Kosos të Përthithjes është më i lartë me 8,000,000 € sepse 5,000 njësi të mbetura në stok "mbartin" me vete koston fikse prej 1,600 € për njësi (5,000 x 1,600 = 8,000,000).

## Problemi 2

### a) Të dhënat e Belyse Enterprises Ltd

Belyse Enterprises Ltd, viti financiar i së cilës përfundoi më 31 dhjetor 2022, merret me shtypjen e teksteve shkollore që përdoren kryesisht nga shkollat fillore dhe të mesme në Ruandë.

Kategoria	Buxheti (Budget)	Aktualisht (Actual)
Njësitë e prodhimit/shitjes	200,000	195,000
	€ "000"	€ "000"
<b>Të ardhurat nga shitja</b>	<b>3,000,000</b>	<b>3,250,000</b>
<b>Kostot Variabël:</b>		
Materiale direkte	900,000 (€ 300/kg)	944,000 (€ 320/kg)
Punë direkte	600,000 (€ 5,000/orë)	562,500 (€ 4,500/orë)
Shpenzime të përgjithshme variabël	800,000 (€ 800/orë pune)	788,500 (€ 830/orë pune)
<b>Gjithsej Kostot Variabël</b>	<b>2,300,000</b>	<b>2,295,000</b>
<b>Kontributi</b>	<b>700,000</b>	<b>955,000</b>
Shpenzime të përgjithshme fikse	200,000	250,000
<b>Fitimi</b>	<b>500,000</b>	<b>705,000</b>

*Kërkohet:*

### Llogaritni variancat (shmangiet) e mëposhtme (16 pikë):

- i) Varianca e çmimit të shitjes
- ii) Varianca e vëllimit të shitjes sipas kostos marginale
- iii) Varianca e çmimit të materialit
- iv) Varianca e përdorimit të materialit
- v) Varianca e tarifës së punës
- vi) Varianca e efikasitetit të punës
- vii) Varianca e shpenzimeve të përgjithshme variabël
- viii) Varianca e efikasitetit të shpenzimeve të përgjithshme variabël

### b) Shpjegoni llojet e mëposhtme të standardeve (4 pikë):

- i) Standardet ideale
- ii) Standardet e arritshme
- iii) Standardet aktuale
- iv) Standardet bazë

(Gjithsej: 20 Pikë)

## Problemi 2 - Zgjidhjet

### a) Llogaritja e variancave (shmangieve)

i) **Varianca e cmimit te shitjes:** (Cmimi i buxhetuar - Cmimi aktual) x Sasia aktuale =  $(15,000 - 16,667) \times 195,000 = 325,000,000$  Euro F

ii) **Varianca e vellimit te shitjes:** (Sasia e buxhetuar - Sasia aktuale) x Kontributi i buxhetuar =  $(200,000 - 195,000) \times 3,500 = 17,500,000$  Euro PF

iii) **Varianca e cmimit te materialit:** (Cmimi i buxhetuar per kg - Cmimi aktual per kg) x Sasia aktuale =  $(300 - 320) \times 2,950,000 = 59,000,000$  Euro PF

iv) **Varianca e perdorimit te materialit:** (Sasia e buxhetuar per prodhim - Sasia aktuale) x Cmimi i buxhetuar =  $(2,925,000 - 2,950,000) \times 300 = 7,500,000$  Euro PF

v) **Varianca e tarifese punes:** (Tarifa e buxhetuar - Tarifa aktuale) x Oret aktuale =  $(5,000 - 4,500) \times 125,000 = 62,500,000$  Euro F.

vi) **Varianca e eficeses se punes:** (Oret e buxhetuara - Oret aktuale) x Tarifa e buxhetuar =  $(117,000 - 125,000) \times 5,000 = 40,000,000$  Euro A.

vii) **Varianca e shpenzimeve variabel:** (Tarifa e buxhetuar - Tarifa aktuale) x Oret aktuale =  $(800 - 830) \times 950,000 = 28,500,000$  Euro PF

viii) **Varianca e eficeses se shpenzimeve variabel:** (Oret e buxhetuara - Oret aktuale) x Tarifa e buxhetuar =  $(975,000 - 950,000) \times 800 = 20,000,000$  Euro F.

### b) Shpjegoni llojet e mëposhtme të standardeve

#### Standardet ideale

Këto bazohen në kushte perfekte të operimit: pa humbje, pa prishje (spoilage), pa joefikasitet, pa kohë të papunë, pa avari/prishje të pajisjeve. Variancat nga standardet ideale zakonisht nënkuptojnë se kemi qenë afër ekzaminimit. Në sisteme me matjen e performancës dhe minimizimin e variancave, standardet ideale ka gjasa të kenë efekt demotivues, sepse variancat negative pothuajse gjithmonë do të shfaqen. Punonjësit shpesh do të ndihen se objektivat janë të paarritshme dhe nuk do të punojnë aq fort.

#### Standardet e arritshme

Këto bazohen në pritjen që një sasi standarde pune do të kryhet në mënyrë efikase, makineritë do të operojnë si duhet, ose materialet do të përdoren si duhet. Disa toleranca lejohet për humbje dhe joefikasitet. Nëse vendosen mirë, ato ofrojnë një stimul psikologjik të dobishëm duke u dhënë punonjësve një objektiv realist por sfidues të efikasitetit. Kërkohet dakordimi dhe bashkëpunimi i punonjësve të përfshirë në përmirësimin e standardit.

#### Standardet aktuale

Këto bazohen në kushtet aktuale të punës (humbje aktuale, joefikasitete aktuale). Disavantazhi i standardeve aktuale është se ato nuk synojnë përmirësimin e niveleve aktuale të efikasitetit.

**Standardet bazë**

Këto mbahen të pandryshuara për një periudhë të gjatë kohe dhe mund të jenë të vjetruara. Përdoren për të treguar ndryshimet në efikasitet ose performancë gjatë një periudhe të gjatë kohe. Standardet bazë ndoshta janë lloji më pak i dobishëm dhe më pak i përdorur i standardit në praktikë.

### Problemi 3

#### (a) Vendimmarrja dhe Kufizimet e Prodhimit

Një biznes prodhon tre produkte: **Alpha, Beta dhe Gama**. Kostot dhe çmimet e shitjes për tre produktet janë si vijon:

Përshkrimi	Alpha (€)	Beta (€)	Gama (€)
Materiale direkte (4,000 € për kg)	20,000	16,000	24,000
Punë direkte (7,000 € për orë)	7,000	14,000	21,000
Shpenzime të ndryshueshme (overhead)	18,000	6,000	12,000
<b>Çmimi i shitjes për njësi</b>	<b>60,000</b>	<b>44,000</b>	<b>78,000</b>

Kërkesa për shitje për periudhën e ardhshme pritet të jetë: **7,000 njësi Alpha, 3,000 njësi Beta dhe 5,000 njësi Gama**.

Furnizimi me materiale është i kufizuar në **50,000 kg** dhe orët e punës në dispozicion janë **28,000 orë**.

*Kërkohet:*

- (i) Identifikimi i faktorëve kufizues (limitues). (2 Pikë)
- (ii) Gjetja e Planit Optimal të Prodhimit dhe Kontributi total. (8 Pikë)

#### (b) Outsourcing (Kontraktimi i jashtëm)

Në vendimmarrje, **outsourcing** përkufizohet si dhënia e punës një pale të jashtme për ta kryer atë në emrin tuaj. Zakonisht rekomandohet që bizneset të kontraktojnë jashtë operacionet ose aktivitetet që nuk janë parësore (non-core).

*Kërkohet:*

- Shpjegoni **katër faktorë** që duhen marrë parasysh përpara kontraktimit të shërbimeve nga jashtë. (4 Pikë)

#### (c) Menaxhimi i Inventarit

**VICTORIA Furniture** është një kompani që blen dhe shet tavolina. Kërkesa vjetore për tavolina është **16,000 në vit**. Kostoja e dorëzimit për çdo tavolinë është **2,500 €** dhe çmimi i blerjes për çdo tavolinë është **36,000 €**. Kostoja e mbajtjes (holding cost) për njësi në vit është **15%**.

*Kërkohet:*

- (i) Llogaritni Sasinë Ekonomike të Porosisë (EOQ). (Rrumbullakoseni në numrin e plotë më të afërt). (2 Pikë)
- (ii) Llogaritni koston totale të porositjes. (2 Pikë)
- (iii) Llogaritni koston totale të mbajtjes së inventarit. (2 Pikë)

(Gjithsej: 20 Pikë)

### Problemi 3 - Zgjidhjet

#### a) i) Identifikimi i faktorëve kufizues

Për të gjetur faktorin kufizues, krahasojmë burimet e nevojshme për të plotësuar kërkesën e tregut me burimet që kemi në dispozicion.

#### Llogaritja e Materialeve të nevojshme:

Produkti	Kg për njësi	Njësi (Kërkesa)	Totali i Kg
Alpha	5	7,000	35,000
Beta	4	3,000	12,000
Gamma	6	5,000	30,000
<b>Gjithsej</b>			<b>77,000</b>

- Materiale në dispozicion: 50,000 kg
- Materiale të nevojshme: 77,000 kg

#### Llogaritja e Orëve të punës të nevojshme:

Produkti	Orë për njësi	Njësi (Kërkesa)	Totali i Orëve
Alpha	1	7,000	7,000
Beta	2	3,000	6,000
Gamma	3	5,000	15,000
<b>Gjithsej</b>			<b>28,000</b>

- Orë pune në dispozicion: 28,000 orë
- Orë pune të nevojshme: 28,000 orë

**Përfundimi:** Materialet janë faktori kufizues sepse kërkesa (77,000 kg) tejkalon furnizimin (50,000 kg).

#### ii) Plani Optimal i Prodhimit dhe Kontributi Total

##### Hapi 2 & 3: Llogaritja e kontributit dhe renditja

Përshwimi	Alpha	Beta	Gamma
Çmimi i shitjes për njësi	60,000	44,000	78,000
Minus: Kostoja variabël	45,000	36,000	57,000
<b>Kontributi për njësi</b>	<b>15,000</b>	<b>8,000</b>	<b>21,000</b>
Kg për njësi (Faktori kufizues)	5	4	6
<b>Kontributi për kg</b>	<b>3,000</b>	<b>2,000</b>	<b>3,500</b>
<b>Renditja (Ranking)</b>	<b>2-të</b>	<b>3-të</b>	<b>1-rë</b>

### Hapi 5: Alokimi i burimeve (Plani Optimal)

Renditja	Produkti	Njësi për prodhim	Kg të përdorura	Kg të mbetura
1-rë	Gamma	5,000	30,000 (6x5,000)	20,000 (50,000 – 30,000)
2-të	Alpha	4,000 (20,000/5,000)	20,000	0
3-të	Beta	0	0	0

### Hapi 6: Kontributi Total

Produkti	Plani Optimal (Njësi)	Kontributi për njësi	Kontributi Total (€)
Gamma	5,000	21,000	105,000,000
Alpha	4,000	15,000	60,000,000
Beta	0	8,000	0
<b>TOTALI</b>			<b>165,000,000</b>

#### b) Faktorët që duhen konsideruar para kontraktimit (Outsourcing)

1. **Cilësia:** Produktet ose shërbimet e kontraktuara duhet të jenë të një standardi të pranueshëm dhe të garantuar.
2. **Vazhdimësia e furnizimit:** Menaxhmenti duhet të jetë i sigurt se furnizimi me mallra ose shërbime nuk do të ndërpritet para skadimit të kontratës.
3. **Çmimi i fiksuar:** Duhet të ekzistojë një marrëveshje për çmim fiks; nëse çmimet ndryshojnë, kushtet duhet të jenë të qarta.
4. **Përdorimi i kapacitetit:** Menaxhmenti duhet të hetojë nëse kapaciteti i liruar mund të përdoret për të gjeneruar fitime shtesë nga produkte të tjera.
5. **Morali i punonjësve:** Duhet marrë parasysh nëse morali i fuqisë punëtore do të ndikohet negativisht nga vendimi për outsourcing.

#### c) Menaxhimi i Inventarit (Victoria Furniture)

##### i) Sasia Ekonomike e Porosisë (EOQ)

- Kërkesa Vjetore (D): 16,000
- Kostoja për dërgesë (Co): 2,500
- Kostoja e mbajtjes (Ch): 15% e 36,000 = 5,400

Llogaritja:  $SPE = 122$  Tavolina

##### ii) Kostoja Totale e Porositjes (TOC)

- Formula:  $(\text{Kërkesa} / \text{Sasia e porosisë}) \times \text{Kostoja për porosi}$
- $(16,000 / 122) \times 2,500 = 327,869€$

##### iii) Kostoja Totale e Mbajtjes (THC)

- Formula:  $(\text{Sasia e porosisë} / 2) \times \text{Kostoja e mbajtjes për njësi}$
- $(122 / 2) \times 5,400 = 329,400€$

#### Problemi 4

a) Shpjegoni dallimin midis humbjes normale dhe humbjes abnormale (jo normale) siç përdoren në koston e procesit. (2 Pikë)

b) RUBIS Ventures është një kompani që përpunon naftën bruto në benzinë. Prodhimi i benzinës kalon nëpër dy procese. Informacioni lidhur me dy proceset paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Detajet	Procesi 1	Procesi 2
Materialet direkte	8,000 litra @ € 5,000 për litër	
Puna direkte	2,000 orë @ € 4,000 për orë	2,200 orë @ € 3,600 për orë
SHPP Variabile	60% e koston së punës	40% e koston së punës
Humbja e pritshme	10%	5%
Çmimi i mbetjeve (scrap)	€ 800 për litër	€ 600 për litër
Prodhimi aktual	7,000 Litra	6,800 litra

*Kërkohet:*

i) Përgatitni llogarinë e procesit 1. (7 Pikë)

ii) Përgatitni llogarinë e procesit 2. (6 Pikë)

c) Në marrjen e vendimeve, menaxherët janë të detyruar të zgjedhin vetëm kostot relevante kur zgjedhin alternativën më të mirë. Kostot relevante zakonisht kanë attribute që i dallojnë ato nga kostot jo-relevante.

*Kërkohet:*

Shpjegoni pesë karakteristika të kostove relevante që konsiderohen në marrjen e vendimeve. (5 Pikë)

(Total: 20 Pikë)

## Problemi 4 - Zgjidhja

a) Shpjegoni dallimin midis humbjes normale dhe humbjes abnormale siç përdoren në koston e procesit

### Humbja Normale

Kjo është humbja e pritshme në një proces prodhimi e cila shprehet si përqindje e sasisë së hyrjes (input-it). Sasia e hyrjes minus humbjen normale jep prodhimin e pritshëm (output-in), i cili normalisht duhet të krahasohet me prodhimin aktual.

### Humbja Abnormale

Humbja abnormale është humbja shtesë që pëson biznesi përtej humbjes së pritshme. Humbja abnormale ndodh kur prodhimi aktual është më i vogël se prodhimi i pritshëm.

#### b.i Përgatitni llogarinë e procesit 1

			Llogaria e procesit 1				
Përshkrimi	Njësi	Çmimi / njësi	Shuma	Përshkrimi	Njësi	Çmimi / njësi	Shuma
Materiale Direkte	8,000	5,000	40,000,000	Humbje Normale (10%*8,000)	800	800	640,000
Punë Direkte			8,000,000	Prodhimi (Output)	7,000	7,244.44	50,711,111
OH Variabël			4,800,000				
				Humbje Abnormale	200	7,244.44	1,448,889
Gjithsej	8,000		52,800,000	Gjithsej	8,000		52,800,000

$$\text{Kosto për njësi (proces 1)} = \{52,800,000 - 640,000\} / \{8,000 - 800\} = 52,160,000 / 7,200 = 7,244.44$$

#### ii. Përgatitni llogarinë e procesit 2

			Llogaria e procesit 2				
Përshkrimi	Njësi	Çmimi	Shuma	Përshkrimi	Njësi	Çmimi	Shuma
Materiale Direkte	7,000		50,711,111	Humbje Normale (5% * 7,000)	350	600	210,000.00

			<b>Llogaria e procesit 2</b>				
Punë Direkte			7,920,000	Prodhimi (Output)	6,800	9,261.52	62,978,339
OH Variabël			3,168,000				
			61,799,111				
Fitim Abnormal	150	9,261.52	1,389,228				
<b>Gjithsej</b>	<b>7,150</b>		<b>63,188,339</b>	<b>Gjithsej</b>	<b>7,150</b>		<b>63,188,339</b>

**Kosto për njësi (procesi 2) = {61,799,111 - 210,000} / {7,000 - 350} = 9,261.52**

*c) Shpjegoni pesë karakteristika të kostove relevante që konsiderohen në marrjen e vendimeve*

1. **Të orientuara drejt së ardhmes:** Kostot që do të shkaktohen në të ardhmen si rezultat i drejtpërdrejtë i një vendimi menaxhues.
2. **Të bazuara në rrjedhën e parasë (Cash flow):** Janë transaksione parash në dorë dhe jo transaksione kontabël ose "mbi letër". Ato përfaqëojnë daljet ose hyrjet aktuale të parave që do të ndodhin si rezultat i një vendimi.
3. **Inkrementale / Diferenciale:** Janë kosto që ndryshojnë ose variojnë midis alternativave të ndryshme. Ato nuk janë kosto të përbashkëta.
4. **Kostot oportune:** Vlera e alternativës që sakrifkohet duhet të merret parasysh gjatë marrjes së një vendimi. Është një kosto që ndikon në vendimin e marrë.
5. **Kostot e shmangshme:** Kostot relevante janë kosto që mund të shmangen kur një vendim nuk merret. Ato duhet të shkaktohen vetëm kur bëhet një zgjedhje. Kur nuk bëhet një zgjedhje, edhe kostoja nuk do të shkaktohet.
6. **Kostot e realizueshme:** Vlera e asgjësimit ose vlera e tregut/vlera e drejtë duhet të merret parasysh gjatë marrjes së një vendimi.

## Problemi 5

a) Duke dhënë shembuj, shpjegoni dallimin midis SHPP të përgjithshme dhe atyre specifike. (4 Pikë)

b) SALLY Enterprises është një kompani me dy departamente prodhimi (A dhe B) dhe dy departamente shërbimi (Depoja dhe Mirëmbajtja). Kompania ka kryer kosto totale overhead prej 13,650,000 € për muajin Mars, 2025. Kostot overhead janë analizuar siç paraqitet në tabelën e mëposhtme:

SHPPtë	Shuma €
Qiraja	2,500,000
Zhvlerësimi (Amortizimi) i Pajisjeve	6,800,000
Kostot e Kantinës	800,000
Kostot e Energjisë Elektrike	1,750,000
Kostot e Ujit	600,000
Kostot e zyreve	1,200,000
<b>Totali i SHPP</b>	<b>13,650,000</b>

### Informacione Shtesë:

Karakteristikat	Dept A	Dept B	Depoja	Mirëmbajtja
Vlera Kontabël e Impiantit	2,000,000	3,500,000	4,500,000	2,500,000
Kilovatët	5,000	8,000	2,400	2,600
Kapaciteti Kubik	360	420	180	240
Numri i Punonjësve	25	40	35	20
Sipërfaqja	3,200	2,600	4,500	3,700

### Kërkohet:

i) Identifikoni bazën më të përshtatshme të shpërndarjes për secilën nga gjashtë SHPP-të. (3 Pikë)

ii) Alokoni dhe shpërndani SHPP-të duke përdorur bazat e shpërndarjes të identifikuara në pikën b) i. më sipër. (13 Pikë)

(Total: 20 Pikë)

## Problemi 5 - Zgjidhja

a)

### SHPP - përgjithshme

Janë kosto indirekte që ndodhin në më shumë se një qendër kostoje. Kostot e përgjithshme duhet të **shpërndahen**. Shpërndarja është ndarja e kostove të përgjithshme në të gjitha departamentet duke u bazuar në bazën më të përshtatshme të shpërndarjes.

- **Shembull:** Qiraja. Qiraja paguhet për të gjithë biznesin, i cili ka më shumë se një departament.

### SHPP - specifike

Janë kosto indirekte që ndodhin në departamente individuale. Kostot specifike duhet të **alokohen**. Alokimi është transferimi i kostove specifike drejtpërdrejt në departamentet e tyre përkatëse.

- **Shembull:** Paga e stafit të departamentit. Stafi punon në departamente individuale dhe pagat e tyre mund të identifikohen me departamentet specifike.

b)i) Identifikoni bazën më të përshtatshme të shpërndarjes për secilën nga gjashtë kostot indirekte

SHPP-të	Baza e Shpërndarjes
Qiraja	Sipërfaqja
Zhvlerësimi i Pajisjeve	Vlera e Librave e Impiantit
Kostot e Kanantinës	Numri i Punonjësve
Kostot e Energjisë Elektrike	Kilovatët
Kostot e Ujit	Kapaciteti Kubik
Kostot e Zyreve	Numri i Punonjësve

b) ii) Alokoni dhe shpërndani kostot indirekte duke përdorur bazat e identifikuara më lart

### Përmbledhja e Alokimit Finale:

Kostoja	Shuma Totale	Dept A	Dept B	Depoja	Mirëmbajtja
Qiraja	2,500,000	571,429	464,286	803,571	660,714
Zhvlerësimi	6,800,000	1,088,000	1,904,000	2,448,000	1,360,000
Kantiere	800,000	166,667	266,667	233,333	133,333
Energjia	1,750,000	486,111	777,778	233,333	252,778
Uji	600,000	180,000	210,000	90,000	120,000
Zyrja	1,200,000	250,000	400,000	350,000	200,000
<b>TOTALI</b>	<b>13,650,000</b>	<b>2,742,206</b>	<b>4,022,730</b>	<b>4,158,238</b>	<b>2,726,825</b>

**Shembull i llogaritjes: Departamenti A:**  $(3,200 / 14,000) * 2,500,000 = 571,429$

**Departamenti B:**  $(2,600 / 14,000) * 2,500,000 = 464,286$

**Depoja:**  $(4,500 / 14,000) * 2,500,000$

$= 803,571$

**Mirëmbajtja (Maintenance):**  $(3,700 / 14,000) * 2,500,000 = 660,714$